

# Udhëzuesi i RAN POL rreth programeve të trajnimit për oficerët e policisë në Evropë

## Hyrje

Oficerët e policisë luajnë një rol kyç në parandalimin e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm. Prej tyre pritet që të dallojnë sinjalet e radikalizimit, por roli i tyre është shumë më i gjerë. RAN POL identifikon katër kompetenca bazë që kërkojnë trajnim:

- Ndërgjegjësimi dhe kuptimi i procesit të radikalizimit, arsyet e lindjes së tij, sinjalet dhe vulnerabilitetet;
- Policimi në komunitet dhe lagje, ndërtimi i rrjeteve të forta të mirëbesimit në shoqëri;
- Ndjeshmëritë ndërkulturore, “policimi për të gjithë” dhe të drejtat e njeriut;
- Policia si palë e efektshme në bashkëpunimin mes multi-agjencive, nisja, mbështetja dhe mundësimi i bashkëpunimit.

Kjo rezulton në tetë tema të ndryshme për programet e trajnimit që duhet të jenë në programin e trajnimit për policinë. Ato do të përshkruhen në këtë Udhëzues të RAN POL, së bashku me programet ekzistuese të trajnimit për secilën nga këto tema.

Ky dokument është shkruar nga **Steven Lenos dhe Marjolein Keltjens**, nga RAN Centre of Excellence.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e RAN Centre of Excellence, të Komisionit Evropian apo të ndonjë institucioni ose pjesëmarrësi tjetër të grupit të punës të RAN POL.

Ky dokument është shkruar nga Steven Lenos dhe Marjolein Keltjens, nga RAN Centre of Excellence.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e RAN Centre of Excellence, të Komisionit Evropian apo të ndonjë institucioni ose pjesëmarrësi tjetër të grupit të punës të RAN POL.

## Falënderimet

Një falënderim i veçantë shkon për drejtuesit e Grupit të Punës të RAN POL, Vasileios Theofilopoulos (EL) dhe Navjot Sandhu (NO) në kontributin e dhënë për këtë udhëzues dhe për drejtimin e sesionit të Grupit të Punës të RAN POL në Athinë (14-15 qershor 2016).

Ky udhëzues është hartuar në bashkëpunim me pjesëmarrësit e takimit në Athinë: Thomas Franklin (AU), Luc Van Der Taelen (BE), Minko Pondev (BU), Andreja Balog Bašić (HR), Chrysostomos Chrysostomou (CY), Jan Pechacek (CZ), Pärtel Preinvalts (EE), Thorsten Stodiek (OSCE), Mario Krebs (EU), Dimitros Krieris (EU), Nathalie Chavanon (FR), Detlef Averdiek-Groener (DE), Kyriakos Braimis (EL), Dr Emmanuel Karagiannis (EL), Akis Karatrandos (EL), Theodoros Schismenos (EL), Vasileios Koutsoliakos (EL), Andrea Kozáry (HU), Dave McNerney (IE), Fabio Germani (IT), Adrian Grima (MT), Rob Out (NL), Andreas Corvalan (NO), Marzena Kordaczuk-Wąs (PL), João Cabaço (PT), Laurentiu Manolea (RO), Mišo Radovančević (SI), Fernando Rojo (ES) and Debbie MacKenzie (UK). Gjithashtu, edhe ekspertët nga Shtetet anëtare që na mbështetën duke dhënë informacione të rëndësishme: Mohamed Ali Abubaker (SE), Desmond Bell (IE), Danijela Petković (HR), Manfred Krauss (DE).

## Hyrje

RAN mbështet fuqimisht investimin në trajnim për specialistët e vijës së parë. Përmes trajnimit ata mund të sensibilizohen rreth rolit të tyre dhe përgjegjësisë të specialistëve të tjerë. Trajnimi i zgjeron kompetencat e kërkuara. Kjo është arsyeja pse RAN POL po e boton këtë udhëzues gjithëpërfshirës rreth trajnimit të oficerëve të policisë.

Në Athinë, u diskutua me ekspertët kombëtarë drafti i parë i “Udhëzuesit të trajnimit për oficerët e policisë” i RAN POL. Ai u hartua nga RAN RAN Centre of Excellence, bazuar në njohuritë e deriatëhershme të RAN POL dhe një anketë online në rrjetin e RAN POL. Ky udhëzues vlerëson me kujdes takimin në Athinë.

Udhëzuesi do të ketë strukturën e mëposhtme:

- Detyrat dhe rolet për policinë në parandalimin e përbashkët të radikalizimit
- Kompetencat e kërkuara dhe trajnimi
- Vërejtjet dhe vëzhgimet kryesore rreth trajnimit
  - Rreth trajnuesve
  - Bëhet fjalë për kulturën, prandaj edhe menaxhimi duhet të trajnohet
  - Në bazë të nevojave
  - Jo vetëm leksione, por edhe krijim përvoja, në vendin e punës, me ushtrime dhe praktikim
  - Trajnim vetëm për policinë apo për grupe të përziera?
- Tetë kapituj të ndryshëm që mbulojnë tetë tema
- Rekomandimet dhe konsiderimet

Ne synojmë që ta bëjmë Udhëzuesin e RAN POL një dokument të gjallë që mund dhe duhet të përditësohet. Në të ardhmen, kur të prezantohen përjasjet e reja të trajnimit për policinë në takimet e RAN POL ose të na dërgohen përmes pikave të kontaktit, këto programe trajnimi mund të shtohen në të.

## Detyrat dhe rolet për policinë në parandalimin e përbashkët të radikalizimit

Trajnimi që nevojitet për oficerët e policisë vjen, ose më saktë, fillon nga roli i policisë. Deklarata e misionit të RAN POL e përshkruan këtë rol si vijon:

*Terrorizmi, ekstremizmi i dhunshëm dhe procesi i radikalizimit janë tradicionalisht subjekte për agjencitë e inteligjencës ose shërbimet sekrete, duke qenë se ato kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare dhe informacione të klasifikuara. Megjithatë **policia ka një rol kyç në mundësimin e përjasjes multi-(ose ndër-) agjenci në nivel lokal dhe rajonal**. Veçanërisht në kontekstin lokal, është policia ajo që shumë shpesh ka rrjetet të forta. Policia i njej shkollat, grupet rinore dhe familjet, por edhe grupet ekzistuese ekstremiste të dhunshme. Policia është një faktor kyç dhe duhet të stimulohet të optimizojë rrjetet profesionale dhe të përfshihet me komunitetet.*

### Elementet kyçe të RAN për parandalimin

Çfarë do të thotë parandalim? Le të përfitojmë sërish nga mundësia për t'u shprehur se çfarë do të thotë termi **parandalim** brenda kontekstit të RAN POL. Kur RAN POL flet rreth parandalimit të radikalizimit, nënkuptohet parandalimi në fazën para-kriminale. Megjithëse arrestimi nga policia i një terroristi që do të kryejë një sulm me bombë parandalon sulmin në shoqëri, ky nuk është lloji i parandalimit ku fokusohet RAN POL.

Katër vjet shkëmbime në komunitetin e specialistëve të RAN kanë sjellë mësim se si parandalimi të jetë i efektshëm. Këto mësim mund të gjenden në mbarë Evropën. Elementet kyçe të RAN për parandalimin e radikalizimit janë të tilla:

1. Radikalizimi është një proces: procese unike, faktorë të shumtë, rrugë të ndryshme.
2. Në Evropë ka shumë ideologji të ndryshme ekstremiste të dhunshme (të ndërlidhura).
3. Parandalim do të thotë mbrojtje e personave dhe komuniteteve vulnerabël.
4. Të rinjtë, familjet dhe komunitetet janë më shpesh viktimat dhe partnerë sesa pika të nxehta dhe autorë të krimeve.
5. Çelësi qëndron te aspekti lokal.
6. Parandalimi është i nevojshëm dhe plotësues për të ndjekur dhe ndërprerë radikalizimin.
7. Multi-agjenci, ndonjëherë edhe ndër-agjenci.
8. Është thelbësore që të ketë specialistë të ndërgjegjësuar dhe të fuqizuar.
9. Kontakt i personalizuar dhe personal.
10. RAN (dhe rrjetet lokale) si një rrjet i hapur dhe transparent.

## Kompetencat e kërkuara dhe trajnimi

Pavarësisht nga ajo që mendojnë disa, roli për policinë është shumë më i gjerë se dallimi i sinjaleve të radikalizimit. Siç u diskutua në takimin e parë për RAN POL e ri në Aarhus (nëntor 2015), është shumë e vështirë që një oficer policie i komunitetit të dallojë sinjalet e radikalizimit. Studiuesi holandez Pieter Appelboom<sup>1</sup> ndau konkluzionet e tij<sup>2</sup>:

“Duket se roli i sinjalizimit të hershëm të rasteve të mundshme të radikalizimit nuk i takon detyrimisht oficerit të policisë të komunitetit (...)

(...)

Megjithatë, roli i oficerit të policisë së komunitetit duket veçanërisht i pranishëm në ndjekjen direkte të radikalizimit, edhe pasi vihet në dijeni për banorë që kanë potencial për radikalizim. Në këtë rol, ata mund të vendosin një copëz më shumë në mozaikun e potencialit për radikalizim, por gjithashtu mund të veprojnë si pika kontakti për individët ose familjet e përfshira. Oficeri i policisë së komunitetit këtu duket se është shumë i përshtatshëm për të portretizuar më shumë një rol proaktiv sesa reagues brenda komunitetit, duke theksuar kështu bashkëpunimin dhe jo pozicionimin në pole të kundërta.”

Pra, cilat janë rolet dhe kontributet potenciale të policisë lokale? Policia ...

- ka informacione për të ndarë dhe për të ofruar, informacione që nuk i njohin palë të tjera;
- është e mirë-pozicionuar për të grumbulluar dhe ndarë informacione mes partnerëve multi-agjenci;
- mund të jetë burim ekspertize dhe këshille rreth radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm për partnerët;
- mund të përdorë mjete dhe masa unike që vetëm ajo i ka;
- është e mirë-pozicionuar për të ndërtuar një rrjet të fortë lokal;
- shumë shpesh është partnere e njohur dhe e besuar për mbrojtjen dhe parandalimin e krimit dhe abuzimit me drogat;
- mund të jetë pikë lidhëse me agjencitë kombëtare dhe shërbimet e inteligjencës;
- mund të jetë shumë e efektshme si me autoritetet lokale ashtu edhe me palë të tjera lokale.

Oficerët e policisë, veçanërisht ata që punojnë në rrjetet lokale, mund të kenë një rol shumë më të madh se dallimin e sinjaleve.

---

<sup>1</sup> Appelboom, Pieter. Roli i oficerit të policisë së komunitetit në sinjalizimin e radikalizimit fetar brenda Holandës (2015)

Katër kompetencat bazë që e shfrytëzojnë plotësisht rolin e policisë:

1. Ndërgjegjësimi dhe njohuria rreth proceseve të radikalizimit që çojnë në terrorizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm. Kjo përfshin sinjalet e procesit të radikalizimit (nuk është e njëjtë si terrorizmi). Gjithashtu, rreth faktorëve që sjellin vulnerabilitete ose faktorëve mbrojtës. Përveç kësaj, kuptimi i ndërhyrjeve që mund të zbusin radikalizimin;
2. Policimi në komunitet: ndërgjegjësimi, qëndrimi dhe aftësitë për të ndërtuar marrëdhënie të besuara në komunitet ose komunitete brenda komunitetit. Komunikimet dhe rrjeti në përgjithësi (jo në mënyrë specifike në komunitetet e pakicave).
3. Ndjeshmëritë ndërkulturore, “policimi për të gjithë” dhe të drejtat e njeriut. Diversiteti, ndjeshmëria ndërkulturore dhe njohuritë, qëndrimi dhe aftësitë për përfshirjen me komunitetet e minoritetit, për t’u përballur me krimin e urrejtjes, diskriminimin dhe për të parandaluar profilizimin racor ose etnik.
4. Si të jeni nismëtar ose partner i efektshëm në bashkëpunimin multi-agjenci ose ndër-agjenci, edhe jashtë botës së sigurisë dhe sigurimit. Për shembull, partnerizimi me punën e të rinjve për mbrojtjen e të rinjve, edukimin, mbështetjen e familjeve dhe me shoqërinë civile..

## Katër kompetenca, tetë tema për programet, tetë kapituj në udhëzues

Ne i ndajmë katër kompetencat bazë të identifikuar më lart në tetë tema që mund të arrihen përmes moduleve të trajnimit. Kjo do të rezultojë në tetë kapituj në këtë Udhëzues të RAN POL. Ne jemi në dijeni të faktit se ka shumë të ngjarë që ka programe trajnimi që mbulojnë më shumë se një prej këtyre temave në një program, por është e dobishme që theksi të vendoset te modulet e veçanta në këtë udhëzues.

1. Programet e trajnimit mbi **radikalizimin** (ndërgjegjësimi, kuptimi, parandalimi, ndërhyrja dhe/ose sinjalizimi);
2. Programet e trajnimit mbi **policimin në komunitet**;
3. Programet e trajnimit mbi **ndjeshmëritë ndërkulturore, “policimin për të gjithë” dhe të drejtat e njeriut** (ndryshimet dhe ndjeshmëritë kulturore, përfshirja me komunitetet e pakicave, paragjykimet dhe profilizimi diskriminues);
4. Programet e trajnimit mbi policinë në **bashkëpunimin multi/ndër-agjenci**;
5. Programet e trajnimit mbi **polarizimin dhe tensionet sociale**;
6. Programet e trajnimit mbi **përdorimin e internetit dhe të medias sociale** për parandalimin e radikalizimit;
7. Programet e trajnimit mbi **komunikimin e efektshëm personal** (qëndrimet, gjuha, gjuha e trupit);
8. Programet e trajnimit mbi rolin e policisë në **deradikalizimin ose shkëputjen** e individëve ekstremistë.

## Vërejtjet dhe vëzhgimet kryesore rreth trajnimit

Përpara se të japim strukturën e tetë kapitujve, do të përshkruhen disa vërejtje të përgjithshme në lidhje me programet e trajnimit për oficerët e policisë.

### Rreth trajnuesve

Zhvillimi i këtyre programeve të lartpërmendura të trajnimit mund të jetë sfidues për trajnuesit. Ato përfshijnë trajtimin e qëndrimeve, anësive dhe paragjyqimeve nga oficerët e përfshirë të policisë. Trajnuesit duhet të jenë në gjendje të trajtojnë këto ndjeshmëri dhe pengesa të mundshme.

Trajnues të jashtëm mund të jenë një vlerë e shtuar, ose janë ndonjëherë edhe të nevojshëm. Nga ana tjetër, kultura e brendshme e policisë nuk është gjithmonë e hapur ndaj personave të jashtëm, prandaj kjo mund të jetë një sfidë për një trajnues të jashtëm. Mund të jetë shumë e efektshme puna në dyshe me një trajnues policie dhe një trajnues të jashtëm (një anëtar i komunitetit, OJQ, aktivist, partner rrjeti).

### Bëhet fjalë për kulturën, prandaj edhe menaxhimi duhet të trajnohet

Policimi në komunitet, policimi ndërkulturor dhe parandalimi u përshkruan në takim si një metodë policimi. Ato nuk janë shumë një temë specifike ekspertize për një pjesë të vogël të forcës policore, por një standard kulture ose madje standard profesional për policimin. Kjo nënkupton se duhet të trajnohet edhe menaxhimi bashkë me kolegët e tjerë të policisë në komunitet. Pjesë e sfidës qëndron në ndryshimin e kulturës së policimit. Puna me kulturën mund të bëhet vetëm nëse ajo ka lidhje me punën aktuale, dhe zhvillohet në trajnimin në ekip.

### Në bazë të nevojave

Trajnimi do të ketë efektin më të madh kur bazohet te problemet dhe te nevojat. Një shembull interesant është programi i trajnimit për trajtimin e pakicave nga policia çeke. Ai filloi si studim se cilat situata shkaktonin tensione për oficerët e policisë gjatë përfshirjes me pakicat. Bazuar në rezultatet e këtij studimi, u zhvilluan programe trajnimi.

### Jo vetëm leksione, por edhe krijim përvoja, në vendin e punës, me ushtrime dhe praktikim

Trajnimi për kompetencat bazë duhet të jetë pjesë e programit të trajnimit fillestar të policisë. Por, ai duhet të ndiqet dhe të rifreskohet gjatë punës. Një oficeri policie në komunitet që patrullon në rrugë, i ofrohet mundësia për të praktikuar aftësitë që kërkohen për policimin në komunitet. Në përgjithësi ekspertët ishin të bindur se praktikimi me simulime, puna me aktorë dhe zhvillimi i ushtrimeve të tjera, janë teknikat e preferuara sepse ato janë më të efektshme. Trajnimi i ditëve të sotme për policinë e ditëve të sotme ka nevojë për metoda moderne si loja serioze, ushtrimet në tavolinë, uebinaret dhe mësimi elektronik (e-learning).

### Trajnim vetëm për policinë apo për grupe të përziera?

Shumica e trajnimit do të ofrohet në shkollat dhe kolegjet e policisë ose në stacionet e policisë. Duke qenë se loja e parandalimit të radikalizimit bazohet në rrjetet lokale dhe punën multi-agjenci me profesionistët e organizatave të ndryshme, duhet marrë në konsideratë zhvillimi i trajnimit në një grup të përzierë. Trajnimi në një grup të përzierë do të rrisë krijimin e rrjetit, besimin reciprok dhe kuptimin, si dhe do t'u japë oficerëve të policisë dhe partnerëve të rrjetit një gjuhë të përbashkët dhe një ndjesi urgjence.

## Kapitulli 1:

### Programet e trajnimit mbi radikalizimin (ndërgjegjësimi, kuptimi, parandalimi, ndërhyrja dhe/ose sinjalizimi)

#### *Pse? Cili është kontributi në rolin e policisë në parandalimin e radikalizimit?*

- Gjithçka fillon me ndjesinë e urgjencës dhe ndërgjegjësimin e oficerëve të policisë për radikalizimin që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm.
- Për të qenë të efektshëm, oficerët e policisë kanë nevojë të kuptojnë proceset e radikalizimit dhe të rekrutimit.
- Oficerët duhet të identifikojnë sinjalet që individët janë vulnerabël, ose edhe që janë në një fazë të caktuar të procesit të radikalizimit ose që po rekrutohen.
- Policia është në gjendje të rrisë ndërgjegjësimin për të tjerët në rrjetin e tyre dhe t'i udhëzojë të kërkojnë sinjale shqetësimi dhe të rrisin rezistencën. Rëndësia dhe të kuptuarit e të drejtave të njeriut.

#### **Mesazhet kryesore**

- Duhet të mbulojnë të gjitha ideologjitë, grupet, proceset dhe terminologjinë ekstremiste.
- Radikalizimi kërcënon sigurinë publike, demokracinë dhe të drejtat themelore, dhe është kërcënim për individët, edhe ata nën moshën madhore, që mund të rekrutohen dhe shfrytëzohen për ideologji ekstremiste.
- Duhet të vendosin theksin te vulnerabilitetet, proceset e radikalizimit dhe të rekrutimit (propaganda).
- Të kuptohen proceset e radikalizimit dhe sjellja dhe veprimet që mund të tregojnë se po ndodh ky proces.
- Ekziston rreziku i krijimit të listave të thjeshta me sinjale të radikalizimit, duke etiketuar me shpejtësi. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të theksohet se të gjitha provat duhet të vlerësohen në grup.
- Tregohuni realist rreth rolit të sinjalizimit për policinë e komunitetit, sinjalet shumicën e kohës vijnë përmes kontakteve lokale jopolicore në rrjetin e policisë.
- Bëni dallim mes fazave para-kriminale, radikalizimit, të radikalizuarve dhe autorëve/terroristëve, si dhe reagimin e duhur nga policia
- Sigurohuni që gjuha, imazhet dhe historitë të kenë lidhje me botën e policisë, por edhe me partnerët civilë të policisë në rrjet (edukimi, kujdesi, puna me të rinjtë OJQ-të).
- Trajnimi u ofron oficerëve një gjuhë që i mundëson policisë të përfshihet me partnerë jopolicorë dhe krijon një rrjet të efektshëm për luftimin e radikalizimit (më pak armë, më shumë te vulnerabilitetet dhe identiteti).
- Kuptoni faktin se shkeljet e të drejtave të njeriut mund të çojnë në radikalizim, dhe në të njëjtën kohë kini parasysh se për pakicat çështja e të drejtave të njeriut është gjithmonë më e rëndësishme se për shumicat.
- Rastet studimore, faktet, mësimet e nxjerra, përmbledhje se si termi radikalizim ka ndryshuar në vitet e fundit ose se si termi do të ndryshojë në të ardhmen dhe se si lidhet kjo me terrorizmin e lindur brenda vendit.
- Zgjidhjet dhe përjasjet e përshtatura për shtete të ndryshme, duke marrë në konsideratë situatën politike, popullatën etj.

## Kapitulli 2:

### Programet e trajnimit mbi policimin në komunitet

**Pse? Cili është kontributi në rolin e policisë në parandalimin e radikalizimit?**

- Të rinjtë, familjet dhe komunitetet janë më shpesh viktime dhe partnerë të mundshëm, sesa pika të nxehta të dyshimta.
- Komunitetet, dhe veçanërisht komunitetet e rrezikuara ndaj ideve ekstremiste, duhet të ndër-gjegjësohen rreth rrezikut të ekstremizmit të dhunshëm dhe duhet të mbrohen kundër rekrutimit.
- Një rrjet i kujdesshëm dhe i fortë në komunitete do të rezultojë në mbërritjen e më shumë informacioneve te policia.
- Policia nuk mund ta bëjë këtë vetëm. Ose nuk është gjithmonë ajo që duhet të veprojë. Kur përballlet me individë që janë pranë rekrutimit ose që janë në procesin e radikalizimit, policia ka nevojë për të tjerë në komunitet për të gjetur reagime, për të ndërhyrë dhe për të vepruar.

#### **Mesazhet kryesore**

- Policimi i afërt ose në komunitet nuk është vetëm një konstrukt organizativ, por një mentalitet. Për të qenë të efektshëm në policimin në komunitet, policia duhet të punojë për ndërtimin e besimit në shoqëri në kohë paqeje dhe për t'u perceptuar si forcë shërbyese dhe mbrojtëse për komunitetet.
- Kjo kërkon një qëndrim të hapur dhe profesionist ndaj komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.
- Nevojiten aftësi bazë për zgjidhjen e problemeve nga oficerët e policisë në komunitet ( modeli SARA), me qëllim identifikimin e nevojave dhe problemeve të komuniteteve dhe zhvillimin dhe implementimin e përbashkët të zgjidhjeve me komunitetet.
- Nuk ekziston vetëm një komunitet. Oficerët e policisë duhet të kuptojnë komunitetet e ndryshme, si të sapoardhurit ashtu edhe komunitetet tradicionale.
- Të përcaktojnë pika kontakti me autoritetet vendore, duke përdorur oficerët e ndërlidhjes.
- Policia duhet të investojë kohë për të sapoardhurit, si refugjatët, për të mbështetur integrimin. Kjo mund të bëhet në programe të përbashkëta me partnerë si autoritetet vendore dhe pakicat.
- Nevojiten oficerë policie të trajnuar mirë. Ata kanë nevojë për aftësi në komunikim, ndërmjetësim, të fitojnë njohuri specifike – kompetencat janë të nevojshme, qëndrimet, ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e prirjeve – mundësisht për krimet e urrejtjes.
- Të qenit oficer i mirë policie në komunitet ka të bëjë me aftësitë në krijimin e rrjeteve dhe ndjeshmëritë që mundësojnë përfshirjen me grupe dhe individë të ndryshëm në komunitet.
- Të paktën pjesë të konsiderueshme duhet të marrin trajnim “në vendin e punës”.



## Kapitulli 3:

# Programet e trajnimit mbi ndjeshmëritë ndërkulturore, “policimi për të gjithë” dhe të drejtat e njeriut

### *Pse? Cili është kontributi në rolin e policisë në parandalimin e radikalizimit?*

- Policia duhet t’u shërbejë të gjithëve, të jetë e efektshme, oficerët kanë nevojë për kompetenca ndërkulturore.
- Rekrutimi dhe radikalizimi me ekstremizëm xhihadist po synon në veçanti komunitete të caktuara pakicash në Evropë.
- Oficerët e policisë duhet të kuptojnë rolin e tyre në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive me të gjitha grupet e pakicave ose pakicat dhe komunitetet e përgjithshme.
- Një pjesë e komuniteteve të pakicave janë vulnerabël dhe kanë nevojë për mbrojtje.
- Komunitetet e prekura të pakicës mund të jenë partnere për t’i rezistuar ekstremizmit, dhe janë zëra më të besuar dhe më të efektshëm në luftën kundër ideve të kundërta dhe alternative.
- Oficerët e policisë duhet të dinë, të kuptojnë dhe të veprojnë brenda ligjit të të drejtave të njeriut.
- Për të luftuar ekstremizmin dhe terrorizmin ekziston rreziku i profilizimit etnik, që sjell reagime negative për policinë.
- Një forcë policore e besuar me kontakte të mira në komunitetet e pakicës do të përfitojë nga raportimi i më shumë sinjaleve shqetësuese.

### **Mesazhet kryesore**

- Oficerët e policisë duhet të jenë të ndërgjegjshëm rreth mënyrës se si perceptohet policia.
- Njohja e efekteve të diskriminimit nëse nuk jeni i ndërgjegjshëm për nevojat dhe zakonet ndërkulturore.
- Profilizimi etnik ose racor ose format e tjera të diskriminimit ose veprimet e njëanshme policore rezultojnë në dëmtimin e marrëdhënieve dhe të mirëbesimit me kulturat e tjera.
- Policia që punon për të gjithë, duhet të veprojë në mënyrë të tillë që rezulton në krijim besimi.
- Të kuptuarit dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut për të gjithë individët është e nevojshme në çdo drejtim.
- Trajtimi i diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes është puna kryesore e policisë (të drejtat e njeriut) dhe do të ndihmojë në menaxhimin e terrenit që shërben si bazë për radikalizimin.
- Zërat e besueshëm duhet të vijnë në fillim nga komunitetet, jo nga policia.
- Oficerët e policisë duhet të dinë një minimum të caktuar rreth diversitetit të pakicave.
- Folësit e jashtëm (nga pakicat) mund të përfshihen për të mësuar rreth fushës; ndoshta mund të bashkohen në një ekip me trajnuesit e policisë.
- Këto programe trajnimi kanë nevojë për shumë përvojë, praktikë dhe diskutim në ekip.
- Këto programe prekin kulturën e policisë; kjo justifikon trajnimin në ekip dhe përfshirjen e menaxhimit.
- Institucionet Kombëtare të Trajnimit të Policisë duhet të hapin dyert për të përfshirë më shumë audiencë (aktivistë, grupet e majta, grupet e organizuara të tifozerisë së futbollit, fetë e ndryshme).

## Kapitulli 4:

### **Programet e trajnimit mbi policinë në bashkëpunimin multi/ndër-agjenci**

#### ***Pse? Cili është kontributi në rolin e policisë në parandalimin e radikalizimit?***

- Përveç sinjalizimit, nisja dhe mbështetja e bashkëpunimit multi-agjenci është një prej roleve kyçe të policisë.
- Parandalimi dhe lufta kundër terrorizmit nuk mund të bëhen vetëm nga policia. Shumë zgjidhje dhe ndërhyrje duhet të vijnë nga të tjerët.
- Parandalimi, njohja dhe luftimi i radikalizimit kërkon një ndarje bashkëpunuese informacioni, përgjegjësish dhe koordinimi të veprimeve të ndryshme.
- Policia duhet të jetë e ndërgjegjshme rreth nevojës së përfshirjes së agjencive dhe palëve të tjera sa më shpejt të jetë e mundur kur planifikojnë përfshirjen e tyre.

#### **Mesazhet kryesore**

- Puna multi-agjenci ose ndër-agjenci duhet të ketë një ndjesi të përbashkët urgjence dhe kuptim të qartë të objektivave. Duhet të qartësohen kontributet dhe kufizimet e palëve të ndryshme.
- Ndërgjegjësimi reciprok rreth roleve dhe kompetencave të veçanta mes të gjitha agjencive.
- Policia duhet të jenë në gjendje t'u shpjegojë palëve të tjera se çfarë mund të bëjë dhe nuk mund të bëjë policia
- Si mund t'i joshë dhe t'i bindë të tjerët policia të bashkëpunojnë?
- Policia që punon në bashkëpunime multi-agjenci duhet të jetë e ndërgjegjshme rreth aspekteve kulturore, organizative dhe legjislative të përfshira.
- Kultivimi i një kulture të përbashkët për bashkëpunimin multi-agjenci.
- Përdorimi i një terminologjie të përbashkët mes palëve përkatëse.
- Protokolle të përcaktuara për ndarjen e informacioneve sipas ligjit dhe për ankesa që lidhen me të drejtat e njeriut, veçanërisht për informacionet konfidenciale.
- Janë njerëzit që bashkëpunojnë, jo organizatat. Prandaj, duhet të investoni në njohuritë, sjelljen dhe aftësitë e oficerëve individualë. Ata duhet të jenë të efektshëm në veprimet e tyre personale.

## Kapitulli 5:

### **Programet e trajnimit rreth polarizimit dhe tensioneve (globale dhe lokale) në shoqëri**

***Pse? Cili është kontributi në rolin e policisë në parandalimin e radikalizimit?***

- Një shoqëri e polarizuar është terreni i përkryer për rekrutuesit dhe ekstremistët.
- Polarizimi mund të përfundojë në gjuhë urrejtjeje, krime urrejtjeje dhe një kërcënim për rendin publik.
- Roli i policisë në shoqëri mund të influencojë polarizimin në mënyrë pozitive ose negative.
- Nevojiten njohuri rreth mekanizmave të polarizimit për të reduktuar polarizimin ekzistues dhe për të parandaluar veprimet që rezultojnë në më shumë polarizim.

#### **Mesazhet kryesore**

- Pasja e opinioneve të kundërta është pjesë e jetës, “ne dhe ata” ndodh normalisht në një nivel të caktuar, por polarizimi serioz është rrezik për shoqërinë dhe për pozicionin e natyrshëm të policisë.
- Njohja e problemeve globale do të ndihmojë në kuptimin e tensioneve lokale.
- Polarizimi mund të jetë i jashtëm (në shoqëri) dhe i brendshëm (brenda policisë).
- Kjo ka të bëjë më shumë me qëndrimin dhe mënyrën se si veprojnë policia si organizatë dhe oficeri si individ.
- A është policia neutrale? Dhe a perceptohet si e tillë. Kjo ka të bëjë me rolin profesionist të policisë në lidhje me bindjet e tyre personale.
- Një qëndrim profesionist “në mes” është kusht paraprak që policia të ruajë legjitimitetin nga të gjitha anët.
- Si mund ta nxisë policia “mesin e heshtur” që është mospjesëmarrje në polarizim dhe preferencë për të qëndruar jashtë polarizimit?

## Kapitulli 6:

# Trajnimi rreth ndërgjegjësimit mbi përdorimin e internetit dhe të medias sociale për parandalimin e radikalizimit dhe kuptimin e rolit të medias tradicionale

### *Pse? Cili është kontributi në rolin e policisë në parandalimin e radikalizimit?*

- Grupet ekstremiste janë shumë të efektshëm në përdorimin e medias sociale për rekrutimin dhe propagandën e tyre.
- Sjellja në realitetin virtual shumë shpesh mund të jetë tregues i vlefshëm i ndryshimit në sjellje, identitetet e zgjedhura dhe besnikëri.
- Oficerët e policisë mund të ndihmojnë partnerë si fëmijët e rritur, prindërit dhe mësuesit, të jenë të ndërgjegjshëm për rreziqet e sjelljes në realitetin virtual të personave të rrezikuar.
- Duke qenë se jeta jonë e përditshme është e pushtuar nga media tradicionale, është e rëndësishme që oficerët e policisë të kuptojnë se si media krijon realitetin social dhe influencën në opinionin e publikut.
- Të kuptuarit se stereotipat e përdorur në media kontribuojnë në procesin e polarizimit dhe shërbejnë si terren për polarizimin.

### **Mesazhet kryesore**

- Oficerët e policisë duhet të kuptojnë mënyrën e veprimit të rekrutuesve dhe radikalizimit në realitetin virtual.
- Policia duhet të fitojë aftësi në njohjen e medias sociale, si p.sh. kontrollin i burimit, ndërgjegjësimin për propagandën e mundshme
- Trajnimi duhet të trajtojë atë që ndodh në realitetin virtual, dhe se si fëmijët e rritur dhe grupet ekstremiste përdorin platforma dhe mjete të ndryshme.
- Media sociale dhe interneti kanë potencial të lartë për oficerët e policisë që duan të kontaktojnë, të komunikojnë dhe të lidhen me publikun.
- Oficerët e policisë duhet të kuptojnë mënyrën e veprimit të organizatave të medias (sensacionet, thjeshtimi i bardhë/i zi, si dhe krijimin e stereotipave).
- Trajnimi duhet të shpjegojë procesin e brendshëm se si krijohen lajmet.

## Kapitulli 7:

### **Programet e trajnimit mbi komunikimin e efektshëm personal (qëndrimet, gjuha dhe gjuha e trupit)**

#### ***Pse? Cili është kontributi në rolin e policisë në parandalimin e radikalizimit?***

- Policia ka nevojë për aleatë në sfidën e parandalimit të radikalizimit. Aleatët e mundshëm duhet të binden rreth urgjencës dhe nevojës për të bashkëpunuar me policinë dhe të tjerët.
- Bindja kryhet me kontaktet e shumta zyrtare dhe më shumë jozyrtare që kanë oficerët e policisë.
- Në të gjitha kontaktet e përditshme, në kohë paqeje dhe në kohë kërcënimesh dhe tensionesh terroriste, është thelbësor komunikimi personal.

#### **Mesazhet kryesore**

- Policia nuk pëlqehet gjithmonë. Oficerët e policisë kanë nevojë për aftësi efektive komunikimi personal për ta kapërcyer këtë dhe për t'i bërë të tjerët të gatshëm të bashkëpunojnë.
- Komunikimi i efektshëm mund t'i ndihmojë oficerët e policisë të krijojnë partneritet me mesazherë të besueshëm, liderë të komunitetit dhe influencues të tjerë.
- Kjo ka të bëjë më shumë me qëndrimin dhe aftësitë sesa me njohuritë.
- Prandaj, trajnimi rreth komunikimit nuk mund të bëhet pa praktikën dhe përvojën, duke punuar me palët e trajnimit.
- Oficerët e policisë kanë nevojë për kapacitetin e duhur për të kapërcyer barrierën gjuhësore me të sapoardhurit, kjo mund të bëhet me aftësi gjuhësore bazë, ose duke përdorur përkthyesit.
- Komunikimi kryhet në ambiente të hapura, në rrugë, por edhe në komunikimin personal me partnerët profesionistë ose qytetarët.
- Ekziston një lidhje mes policimit për të gjithë dhe efektshmërisë në komunikim me pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme.
- Bota virtuale ofron mundësi të reja për komunikim.

## Kapitulli 8:

### **Programet e trajnimit mbi rolin e policisë në deradikalizimin dhe shkëputjen e individëve ekstremistë**

#### ***Pse? Cili është kontributi në rolin e policisë në parandalimin e radikalizimit?***

- Në të gjithë Evropën ka individë të radikalizuar. Rreziku që ata t'i drejtohen dhunës kundër shoqërisë duhet të ulet përmes ndërhyrjeve të deradikalizimit ose shkëputjes së tyre.
- Kjo në shumicën e shteteve nuk është roli i oficerëve të policisë, por në disa shtete oficerët e policisë po marrin pjesë në përjasje multi-agjenci që synojnë shkëputjen ose madje deradikalizimin.
- Oficerët e policisë duhet të dinë se si mund të mbështesin deradikalizimin ose shkëputjen në kontaktet dhe veprimet e tyre. Të paktën, policia duhet të dijë se çfarë *nuk* duhet të bëjë për të mos penguar deradikalizimin.

#### **Mesazhet kryesore**

- Policia duhet të ketë jo vetëm ekspertizë mbi faktorët dhe procesin që i çon njerëzit më larg drejt të grupeve ose ideologjive ekstremiste, por edhe mbi faktorët që mund t'i ndihmojnë individët të largohen nga idetë dhe grupet e dhunshme ekstremiste.
- Ky modul mund të jetë një shtojcë për një modul trajnimi mbi radikalizimin.
- Këtu mund të hyjë në punë ndoshta ekspertiza e gjerë në parandalimin e krimit.

## Rekomandimet dhe konsiderimet

Disponohet një gamë e gjerë programesh trajnimi: ndajini ato!

Brenda kapaciteteve të kufizuara të një grupi pune të RAN, ne menaxhuam të identifikojmë një gamë të gjerë programesh trajnimi. Nga disa shtete nuk gjetëm shumë, të tjera kishin një portofol të pasur me programe trajnimi të mirëtestuara dhe të përmirësuara. Dhe është e sigurt që nuk i gjetëm të gjitha.

Disa pika kontakti vunë në dukje se kishin nevojë për programe specifike, ndërsa të tjera kishin një numër programesh që i trajtonin këto tema. Një shkëmbim dhe ndarje e programeve ekzistuese do të ndihmonte Shtetet anëtare të përmirësonin programet dhe kapacitetet e tyre të trajnimit me shpejtësi të lartë.

Kishte një dëshirë të madhe për të përkthyer programet ekzistuese të trajnimit dhe për zhvillimin e programeve të mësimin elektronik e-learning. Këto janë skenarë, studime rastesh ose pjesë teo-rike që mund të përdoren edhe në shtete të tjera, nëse do të përktheheshin.

*U bëjmë thirrje Shteteve anëtare, institucioneve evropiane, shkollave dhe akademive të policisë të kontaktojnë njëra-tjetrën, dhe të ndajnë materialet e zhvilluara deri tani me fonde publike. Në këtë mënyrë, specialistët në të gjithë Evropën mund të trajnohen me materialet më të reja dhe më cilësore.*

### Më shumë sesa sinjalizim

Për oficerët e policisë, por edhe për specialistët e tjerë, trajnimi duhet të jetë në përputhje me rolin e tyre të kërkuar dhe specifik dhe kontributin në bashkëpunimin multi-agjenci ku ata duhet të punojnë. Kjo përfshin parandalimin, ndarjen e informacionit, përcaktimin e reagimeve dhe zbatimin e tyre.

*Përveç sinjalizimit, e rëndësishme në trajnim është mbështetja e parandalimit, polici-mi në komunitet dhe nisja dhe mundësimi i punës multi-agjenci.*

### Mbajtja e përditësuar, vëmendja ndaj trajnimit

Mënyra e veprimit të grupeve ekstremiste po ndryshon. Për shembull, rritja e sulmeve të ndryshme nga “ujq të vetmuar” dhe përfshirja në sulme të organizuara në grup. Fluksi i refugjantëve dhe integrimi në komunitetet pritëse kanë ndikim në luftën kundër terrorizmit të dhunshëm dhe programet e trajnimit që mbështesin specialistët. Kjo kërkon përditësim të vazhdueshëm të programeve të trajnimit. Në të njëjtën kohë, zhvillohen, testohen, vlerësohen dhe përmirësohen programe trajnimi. Ne kemi përshtypjen se do të fitohet shumë duke i ndarë këto përvoja dhe informacione. Ne shpresojmë që disa programe trajnimi të mund të vlerësohen.

RAN sigurisht që mund të luajë rol në këtë fushë. Për shembull, përmes një evenimenti tematik mbi programet e trajnimit. Ne nuk u referohemi vetëm programeve të trajnimit, por edhe programeve për personelin e burgjeve, edukuesit dhe në grupe mikse.

*Rishikimi dhe diskutimi i programeve të trajnimit duhet të jetë pjesë e politikave të luftës kundër terrorizmit të dhunshëm dhe ndarjes në nivel ndërkombëtar, brenda RAN dhe në shkëmbime të tjera.*

*Në Programin e ardhshëm Vjetor, RAN POL do ta vendosë edhe një herë fokusin te trajnimi.*

RAN POL pati kënaqësinë e pjesëmarrjes së CEPOL, OSBE-së dhe AEPC. Ekziston një nevojë për më shumë ndarje ndërkombëtare të përvojave, duke parë materialet ekzistuese. RAN POL, brenda kufizimeve të veta, është e hapur për bashkëpunim në të ardhmen për të garantuar që oficerët e policisë të marrin trajnimin që u nevojitet për punën e tyre.

### **Refugjatët, incidentet, sulmet dhe polarizimi**

Evenimenti tematik, Dokumenti i politikës dhe Seminaret që organizoi Qendra e Ekselencës së RAN, të gjitha theksojnë sfidat e reja për luftën kundër terrorizmit të dhunshëm për shkak të efekteve të refugjatëve dhe emigrantëve që mbërritën në Shtetet anëtare të BE-së. Ekzistojnë tendenca shqetësuese në lidhje me polarizimin, ekstremizmin e djathtë, ekstremizmin xhihadist, ekstremizmin e majtë, dhe ekstremizmin anarkist.

Rekomandojmë që të kontrolloni programet ekzistuese të trajnimit për të qenë i përditësuar për shkak të efekteve të krizës së refugjatëve dhe emigrantëve në ekstremizmin e djathtë, radikalizimin reciprok dhe polarizimin.



## Aneksi: Shembuj të programeve ekzistuese premtuese të trajnimit në Shtetet anëtare të BE-së

### Kapitulli 1: Programet e trajnimit mbi radikalizimin (ndërgjegjësimi, kuptimi, parandalimi, ndërhyrja dhe/ose sinjalizimi)

<b>Emri</b>	Luftimi dhe parandalimi i radikalizimit dhe i ekstremizmit
<b>Vendi</b>	Maltë
<b>Objektivat mësimore</b>	Të kuptojmë radikalizimin dhe ekstremizmin
<b>Për</b>	Oficerët e policisë nga distrikte dhe degë të ndryshme
<b>Kohëzgjatja</b>	4 orë në ditë për çdo grup
<b>Fokusi</b>	Njohuritë dhe aftësitë

<b>Emri</b>	Masat kundër radikalizimit dhe ekstremizmit
<b>Vendi</b>	Greqi
<b>Objektivat mësimore</b>	Krijimi i një grupi trajnuesish në fushën e ndërgjegjësimit të publikut për parandalimin
<b>Për</b>	Oficerët e zbatimit të ligjit – specialistët e vijës së parë
<b>Kohëzgjatja</b>	Pesë muaj
<b>Fokusi</b>	Njohuritë dhe aftësitë

<b>Emri</b>	Fuqizimi i policisë greke për të luftuar radikalizimin dhe ekstremizmin
<b>Vendi</b>	Greqi
<b>Objektivat mësimore</b>	Fuqizimi operacional i personeli të policisë greke për të luftuar radikalizimin dhe ekstremizmin
<b>Për</b>	Personelin e policisë greke
<b>Kohëzgjatja</b>	Dy vjet
<b>Fokusi</b>	Njohuritë, qëndrimi dhe aftësitë

<b>Emri</b>	Trajnimi i oficerëve të policisë së vijës së parë mbi treguesit e përbashkët të rrezikut të luftëtarëve të huaj terroristë
<b>Vendi</b>	Greqi
<b>Objektivat mësimore</b>	Identifikimi i treguesve të përbashkët të rrezikut dhe njohuritë bazë të procesit të radikalizimit
<b>Për</b>	Oficerët e policisë së vijës së parë (oficerët e kontrollit kufitar dhe të pasaportave)
<b>Kohëzgjatja</b>	Gjashtë orë
<b>Fokusi</b>	Aftësitë

<b>Emri</b>	Radikalizimi që çon në ekstremizëm të dhunshëm
<b>Vendi</b>	Slloveni
<b>Objektivat mësimore</b>	Njoha, ndërgjegjësimi, Parandalimi
<b>Për</b>	Të gjitha strukturat brenda policisë dhe subjektet e RAN
<b>Kohëzgjatja</b>	Dy vjet, deri në 2 orë leksione
<b>Fokusi</b>	-

<b>Emri</b>	Komponent i fortë i kurrikulës
<b>Vendi</b>	Gjermani

<b>Objektivat mësimore</b>	Të theksohet rëndësia dhe natyra qendrore e çështjes së të drejtave të njeriut për rolin dhe imazhin vetjak të policisë dhe të mbrohen të drejtat e njeriut nga kërcënimet në një shtet që drejtohet nga shteti ligjor
<b>Për</b>	Studentët e Administrimit të Policisë (B.A.)
<b>Kohëzgjatja</b>	Praktikë tre vjet
<b>Fokusi</b>	Njohuritë, qëndrimi dhe aftësitë

<b>Emri</b>	Radikalizimi i dhunshëm
<b>Vendi</b>	Qipro
<b>Objektivat mësimore</b>	Të kuptojmë se çfarë është radikalizimi i dhunshëm. Të kuptojmë shenjat dhe treguesit e radikalizimit. Të identifikojmë personat vulnerabël ndaj radikalizimit. Të përcaktojmë rolin e internetit dhe medias sociale
<b>Për</b>	Oficerët e rekrutuar, oficerët e policisë së komunitetit, oficerët e emigracionit dhe të të huajve, oficerët e Departamentit të Hetimit të Krimeve, Personeli i burgut
<b>Kohëzgjatja</b>	3 orë
<b>Fokusi</b>	Njohuria dhe qëndrimi

<b>Emri</b>	Teknikat kryesore të deradikalizimit në policimin në komunitet
<b>Vendi</b>	Irlandë
<b>Objektivat mësimore</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i partneriteteve të komunitetit përmes policimit në komunitet</li> <li>2. Ndërtimi i besimit dhe i konfidencës me komunitetet me pakica.</li> <li>3. Një përmbledhje e protokolleve etnike kulturore dhe fetare të përhapura në komunitetet lokale.</li> <li>4. Aplikimi ligjor antidiskriminues nga policia e vijës së parë në komunitet.</li> <li>5. Familjarizimi i policisë së vijës së parë me specifikat e ekstremizmit dhe racizmit të dhunshëm</li> <li>6. Trajtimi i të gjitha formave të ekstremizmit për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin</li> </ol>
<b>Për</b>	Oficerët e policisë së vijës së parë në komunitet dhe policët etnikë të betuar me emërim të veçantë Oficerët e ndërlidhjes
<b>Kohëzgjatja</b>	Dy ditë
<b>Fokusi</b>	Njohuri intensive, fokusim te qëndrimi dhe aftësitë

<b>Emri</b>	PLIR - Vija e parë kundër radikalizimit
<b>Vendi</b>	Rumani
<b>Objektivat mësimore</b>	Synimi i programit është të rritet ndërgjegjësimi i oficerëve të policisë së vijës së parë
<b>Për</b>	40 oficerë policie nga Policia Kombëtare, Policia Kufitare, Policia e Emigracionit dhe Xhandarmëria
<b>Kohëzgjatja</b>	6 orë në ditë, 5 ditë
<b>Fokusi</b>	Oficerët e policisë së vijës së parë duhet të jenë vigjilentë për emblemat, dokumentet, fletëpalosjet, veshjet, të konvertuar gjatë kontakteve me policinë, ndalimeve të trafikut dhe kontrolleve të shtëpive

<b>Emri</b>	Kurs kryesor parandalues
<b>Vendi</b>	Mbretëria e Bashkuar
<b>Objektivat mësimore</b>	Të kuptojmë personat vulnerabël ndaj radikalizimit dhe referimi i tyre për ndihmë
<b>Për</b>	Oficerët parandalues
<b>Kohëzgjatja</b>	3 ditë
<b>Fokusi</b>	Njohuria

<b>Emri</b>	Plani i trajnimit për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm
<b>Vendi</b>	Spanjë
<b>Objektivat mësimore</b>	Rritja e njohurive në një aktivitet profesional të përditshëm. Konceptet e radikalizimit. Aspektet e radikalizimit të dhunshëm. Treguesit e jashtëm. Përmirësimi i kapacitetit të marrëdhënieve me shoqërinë dhe grupet sociale.
